



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

Nr.006/2020
Datë: 11.02.2020

Kryeministri i Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 94 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 6 (4.1) dhe nenin 12 të Rregullores Nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (GZ, Nr. 1, 18 prill 2011), e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, Rregulloren Nr. 16/2017, Rregulloren Nr. 07/2018, Rregulloren Nr. 26/2018 dhe Rregulloren Nr. 30/2018, nxjerr:

V E N D I M

1. Z. Avni Zogiani emërohet Zëvendësministër në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Ambientit.
2. Zëvendësministri emërohet për mbështetjen e Ministrit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Ambientit dhe është përgjegjës për menaxhimin e aktiviteteve në fushat e përcaktuara nga Ministri, si dhe për zëvendësimin e Ministrit kur ai mungon ose kur nuk është në gjendje të kryejë detyrën e tij.
3. Zëvendësministri, brenda tridhjetë (30) dite nga hyrja në fuqi e këtij Vendimi është i obliguar të bëjë deklarinimin e pasurisë, në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-050 për deklarinimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarinimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtar, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-228 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-050.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryeministri.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Vendimi i dërgohet:

- Z. Avni Zogianit, Zëvendësministër në MIA;
- Të gjithë Zëvendëskryeministrave;
- Të gjithë Ministrave;
- Shefit të stafit të Kryeministrit;
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së;
- Arkivit të Qeverisë.